



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



PULSI PUBLIK XXI



Nëntor 2021

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve nga anketa dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it.

PËRMBAJTJA

- 7** Përmbledhje ekzekutive
- 9** Treguesit kyç të Pulsit Publik
- 10** Drejtimi politik
- 12** Siguria personale
- 13** Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë
Ekonomike
- 15** Drejtimi Ekonomik
- 16** Problemet madhore me të cilat përballet Kosova
aktualisht
- 18** Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat
- 19** Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë
- 20** Qëndrimet kundrejt votimit
- 25** Mjedisi
- 29** COVID-19
- 32** Metodologjia
- 32** - Peshimi i totaleve të popullatës
- 33** - Përlllogaritja e Indekseve

LISTA E TABELAVE

- 9 Tabela 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore në Kosovë
- 14 Tabela 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së
- 15 Tabela 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së
- 20 Tabela 4 Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë

LISTA E FIGURAVE

- 10 Figura 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës
- 11 Figura 2 Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike
- 12 Figura 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë
- 13 Figura 4 Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike
- 16 Figura 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës
- 17 Figura 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht
- 18 Figura 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik
- 19 Figura 8 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat
- 21 Figura 9 Arsytet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë
- 22 Figura 10 Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë
- 22 Figura 11 Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë
- 23 Figura 12 Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë
- 23 Figura 13 Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore mbahen së shpejti
- 24 Figura 14 Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike
- 25 Figura 15 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër
- 26 Figura 16 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike
- 27 Figura 17 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre
- 28 Figura 18 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike

- 28** Figura 19 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë
- 29** Figura 20 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike
- 29** Figura 21 Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor
- 30** Figura 22 Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike
- 31** Figura 23 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19
- 31** Figura 24 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike

Përmbledhje ekzekutive

Përmbledhja e Pulsit Publik ofron një pasqyrë të dhjetë treguesve kyç që nxirren nga anketat e opinionit të kryera dy herë në vit me të anketuarit në Kosovë.¹ Përmbledhja e Pulsit Publik XXI bazohet në anketën e opinionit të realizuar nga 20 tetori deri më 4 nëntor 2021, me 1,306 të anketuar nga të gjitha komunitetet etnike në Kosovë. Të dhënat dhe treguesit nga anketa e opinionit zërthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptimet për problemet zhvillimore me të cilat përballen qytetarët në Kosovë.

Niveli i kënaqshmërisë me performancën e ekzekutivit kapi vlerën 47.6%, çka përbën një ulje prej 11.5 pikë përqindjeje nga anketa e majit 2021 kur kjo vlerë ishte 59.1%. Niveli i regjistruar i kënaqshmërisë me punën e Kryeministrit është 53.2% (59.5% në maj 2021), ndërsa me punën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës është 55.5% (59.2% në maj 2021). Niveli i kënaqshmërisë me Presidenten kapi vlerën prej 55.2%, krahasuar me shkallën e kënaqshmërisë prej 63.7% të regjistruar në maj 2021. Ka pasur rritje të shkallës së kënaqshmërisë me Zyrën e Kryeprokurorit, me shkallë të kënaqshmërisë prej 34% (30.8% në maj 2021).

Indeksi i Demokratizimit (ID) u rrit me 0.01 pikë (1.59) krahasuar me majin 2020, kur kjo vlerë ishte 1.58 pikë. Edhe Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) është rritur nga maji 2021 (1.49) dhe kapi vlerën e 1.52 pikëve, duke shënuar për herë të parë një vlerësim pozitiv për IBE-në. Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) në 3 pikë (maksimumi), ku vlerat nën 1.5 konsiderohen negative, ndërsa ato mbi 1.5 tregojnë qëndrim pozitiv të shumicës së qytetarëve në lidhje me indekset e demokratizimit dhe ekonomisë.

Një numër pak më i ulët i të anketuarve janë të gatshëm të protestojnë për arsye politike në periudhën tetor-nëntor 2021 sesa në maj 2021 (36.7%). Edhe të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë rënie të gatishmërisë për të protestuar. Kjo vlerë në mesin e shqiptarëve të Kosovës ishte 37.1% krahasuar me 39.5% në maj 2021, dhe 7.1% në mesin e serbëve të Kosovës krahasuar me 23.3% në maj 2021, dhe 30.8% në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (32.3% në maj 2021).² Teksa përqindja më e madhe e të pakënaqurve me drejtimin politik në Kosovë ishte më e larta mes serbëve të Kosovës (47.6%), 32.6% e shqiptarëve të Kosovës ishin të pakënaqur me drejtimin aktual politik. Përqindja më e madhe e të anketuarve që nuk ishin as të kënaqur e as të pakënaqur me drejtimin politik ishte ndër komunitetet tjera të Kosovës (40.5%).

Gjetjet nga anketa e opinionit të Pulsit Publik XXI tregojnë rënie të lehtë të ndjenjës së sigurisë tek të anketuarit, me 73.6% që ndihen të sigurt kur janë jashtë, krahasuar me 76.4% në maj 2021. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se ndjenja e sigurisë është më e ulët mes femrave (71.5%) sesa mes meshkujve (75.4%).

¹ Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

² Për qëllimet e kësaj ankete të opinionit, termi "komunitete të tjera të Kosovës" përfshin ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës.

Ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës është rritur me 16.1 pikë përqindjeje, me 50.9% që ndihen të sigurt në periudhën tetor-nëntor 2021 krahasuar me 38.4% në maj 2021. Në mënyrë të ngjashme me anketën e mëparshme, ndjenja më e lartë e sigurisë është regjistruar në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, me 85% (85% në maj 2021) që ndihen të sigurt kur janë në rrugë. Gjithsej 73.6% e shqiptarëve të Kosovës ndiheshin të sigurt në rrugë.

Anketa e Pulsit Publik e periudhës tetor-nëntor 2021 hulumtoi edhe problemet kryesore me të cilat përballet Kosova aktualisht. Gjetjet tregojnë një ndryshim nga anketa e mëparshme në tri çështjet madhore që ndikojnë në mirëqenien sociale, me problemet mjedisore që ia kanë zënë vendin korrupsionit si çështja e tretë më kryesore. Tri çështjet kryesore të raportuara gjatë këtij anketimi ishin papunësia (26.7%), varfëria (24.3%) dhe mjedisi (10.1%). Krahasuar me majin e vitit 2021, korrupsioni (9.3%) ka rënë me 4.5 pikë përqindjeje. Problemet e hapësirës urbane dhe çmimet e artikujve esenciale janë ndër 5 çështjet kryesore me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Serbët e Kosovës i konsiderojnë problemet e hapësirës urbane (20%), papunësinë (13.8%) dhe sigurinë publike dhe personale (11%) si tri çështjet kryesore, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh është papunësia (58.5%), pasuar nga problemet e hapësirës urbane (14%) dhe mjedisi (5.5%). Për shqiptarët e Kosovës, varfëria (26.5%), papunësia (25.1%) dhe mjedisi (10.4%) janë tri problemet madhore në Kosovë. Gjithsej 72.8% e të anketuarve konsiderojnë së punësimi në institucionet publike në Kosovë nuk bëhet në baza meritore, krahasuar me majin 2021 kur këtë e besonin 76% e të anketuarve. Mesatarisht, 23.4% e anketuarve pohojnë se perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, një rënie prej 1.6 pikë përqindjeje nga maji 2021 (25%).

Sa i përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, gjithsej 7.9% e të anketuarve thanë se dinë shumë për këtë temë, 24.9% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 39.7% e të anketuarve thanë se pak dinë për këtë temë. Gjithsej 27.5% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, një rritje prej 12.3 pikë përqindjeje nga maji 2021 (15.2%).

Gjithsej 29.4% e të anketuarve besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime kundrejt 37.1% që nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë. Gjithsej 77.6% e të anketuarve do të votonin për një parti të caktuar politike, ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në të ardhmen e afërt. Gjithsej 51% e të anketuarve deklaruan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në mirëqenien e tyre ekonomike. Gjithsej 43.9% deklaruan se ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre fizik dhe 50.7% treguan se ka ndikuar në shëndetin e tyre mendor. Vërehet një rënie në kënaqshmërinë e qytetarëve me masat e marra nga Kabineti Ekzekutiv për parandalimin e përhapjes së COVID-19, me 32.3% të të anketuarve që janë të kënaqur me këto masa, kundrejt 43.6% në maj 2021.

Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete do të bëhen të disponueshme përmes Platformës për Vizualizimin e të Dhënave të Pulsit Publik dhe ASKData.³

³ Platforma për Vizualizimin e të Dhënave: <https://app.powerbi.com/view?r=eyJrljoiNTUzMjMzZjAtNmZlMCOONmQ2LTg3YjAtNmZmOWY2MTNiMTBlIiwidCI6ImZzTVkyYjVlLTl5NDQtNDgzNy05OWY1LT-c0ODhhY2U1NDMxOSIsImMiOjh9>

ASKData është një platformë e Agjencisë së Statistikave të Kosovës: <https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/>.

Treguesit kyç të Pulsit Publik

Rezultatet e anketës së Pulsit Publik të vjeshtës 2021 tregojnë një rënie të lehtë të niveleve të kënaqshmërisë me të gjitha institucionet e Kosovës krahasuar me anketën e zhvilluar në maj 2021, përveç se me Zyrën e Kryeprokurorit. Mesatarisht, 47% e të anketuarve janë të kënaqur me punën e institucioneve qendrore të Kosovës krahasuar me 51.4% në maj 2021, 27.5% në dhjetor 2020 dhe 42.5% në prill 2020.

Kënaqshmëria me punën e Presidentes së Kosovës kapi vlerën 55.2%, krahasuar me 63.7% në nëntor 2021. Kënaqshmëria me punën e Kryeministrit kapi vlerën 53.2% (59.5% në maj 2021). Kënaqshmëria me kabinetin ekzekutiv kapi vlerën 47.6% krahasuar me majin 2021 kur ishte 59.1%. Niveli i kënaqshmërisë me Kryetarin e Kuvendit ishte 55.4% (59.2% në maj 2021), ndërsa kënaqshmëria me punën e Kuvendit të Kosovës ishte 50.3% (52.9% në maj 2021).

U vërejt një rënie e lehtë në kënaqshmërinë me punën e gjykatave (33.9%) krahasuar me majin 2021 (34.6%). Gjithsej 34% e të anketuarve kishin pikëpamje pozitive për punën e Prokurorisë, krahasuar me 30.8% në maj 2021. Vitet e fundit, niveli më i lartë i kënaqshmërisë me punën e Prokurorisë është regjistruar në nëntor 2018 (35.3%). Në përgjithësi, kënaqshmëria e qytetarëve me gjyqësorin tregon një rritje të qëndrueshme krahasuar me nëntorin 2019 (përkatësisht 13.6% dhe 14.2%) dhe majin 2019 (përkatësisht 18.7% dhe 16.4%) si dhe përgjatë vitit 2020, siç tregohet në tabelën më poshtë.

Tabela 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë


Treguesit politikë		Pri - 16	Tet - 16	Tet - 17	Maj - 18	Nën - 18	Maj - 19	Nën - 19	Pri - 20	Dhj - 20	Maj - 21	Nën - 21	Trendi
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Kabineti ekzekutiv	17.80%	20.20%	32.40%	30.00%	31.30%	17.70%	14.40%	60.70%	21.30%	59.10%	47.60%	
	Kryeministri	18.30%	19.70%	42.30%	33.20%	35.10%	36.50%	20.70%	65.40%	23.00%	59.50%	53.20%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	17.30%	18.90%	31.70%	32.90%	36.10%	19.60%	18.60%	33.40%	22.60%	52.90%	50.30%	
	Kryetari i Kuvendit	24.30%	24.90%	36.00%	31.50%	36.30%	23.60%	20.50%	72.40%	46.70%	59.20%	55.40%	
Kënaqshmëria me Presidenten	Presidentja	45.70%	25.50%	37.60%	39.10%	38.40%	20.40%	21.20%	18.70%	33.90%	63.70%	55.20%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	18.40%	22.10%	36.90%	31.20%	37.80%	18.70%	13.60%	24.80%	23.00%	34.60%	33.90%	
	Prokuroria	16.90%	16.30%	33.10%	29.90%	35.30%	16.40%	14.20%	22.30%	23.00%	30.80%	34.00%	

Drejtimi politik

Përqindja e të anketuarve që janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës është rritur për 6 pikë përqindjeje (30.7%) krahasuar me anketën e majit 2021 (24.7%) dhe paraqet nivelin më të lartë të kënaqshmërisë të regjistruar ndonjëherë nga anketat e Pulsit Publik. Kjo paraqet një rritje domethënëse krahasuar me 13.4% në dhjetor 2020 dhe 10.6% në prill 2020. Në këtë mënyrë, është ulur numri i atyre që nuk janë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, duke treguar nivelin më të ulët të pakënaqësisë të regjistruar ndonjëherë nga anketat e opinionit të Pulsit Publik, me 33.2% të pakënaqur kundrejt 36.4% në maj 2021, 59.4% në dhjetor 2020 dhe 69.6% në prill 2020. Edhe numri i atyre që janë neutral ka rënë në krahasim me majin 2021, me 36.1% kundrejt 38.8% në maj 2021. Sidoqoftë, ky numër është rritur në krahasim me dhjetorin 2020 (27.2%) dhe prillin 2020 (19.7%).


Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se një pjesë më e madhe e femrave janë shumë të kënaqura dhe të kënaqura (32.6%) me drejtimin politik të Kosovës në krahasim me meshkujt (28.6%). Në të njëjtën kohë, përqindja e meshkujve që janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur (38.5%) me drejtimin politik të Kosovës është më e lartë se ajo e femrave (29.8%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë ngjashmëri në nivelin e kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës mes shqiptarëve të Kosovës (31.7%) dhe komuniteteve të tjera të Kosovës (30.5%). Niveli i kënaqshmërisë në mesin e serbëve të Kosovës mbetet i ngjashëm me anketën e mëparshme (9.1%), me 9% që janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Në këtë mënyrë, niveli më i lartë i pakënaqësisë gjendet tek serbët e Kosovës (47.6%), ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (32.6%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (29%). Përqindja e atyre që janë neutral në vlerësimin e tyre për drejtimin politik të Kosovës është mjaft e lartë, me 41.9% të serbëve të Kosovës, 40.5% të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 35.4% të shqiptarëve të Kosovës.

Figura 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës



Numri i të anketuarve të gatshëm t'iu bashkohen protestave politike ka rënë për 1.1 pikë përqindje që nga maji 2021. Gjithsej 35.6% e të anketuarve janë të gatshëm t'iu bashkohen protestave politike në krahasim me 36.7% në maj 2021. Megjithatë, ky numër është më i lartë se në dhjetor 2020 (30.6%), prill 2020 (33.6%) dhe nëntor 2019 (31.3%), por më i ulët se në maj 2019 (42.2%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se shqiptarët e Kosovës janë më të gatshëm të protestojnë sesa serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Koncretisht, 37.1% e shqiptarëve të Kosovës janë të gatshëm të protestojnë, kundrejt 7.1% të serbëve të Kosovës dhe 31% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Krahasuar me majin 2021, gatishmëria e serbëve të Kosovës për të protestuar për arsye politike ka rënë në mënyrë drastike nga 23.3% në 7.5%. Edhe numri i shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës që janë të gatshëm të protestojnë për arsye politike ka rënë nga maji 2021, përkatësisht për 2.4 dhe 1.5 pikë përqindjeje.


Figura 2 Përqindja e të anketuarve që do t'iu bashkoheshin protestave politike



Siguria personale

Për të matur perceptimin për sigurinë publike, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë jashtë në rrugë në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Gjetjet tregojnë një rënie të lehtë të perceptimit të sigurisë për 2.8 pikë përqindjeje (73.6%) krahasuar me majin 2021 (76.4%). Niveli më i lartë i sigurisë u regjistrua në prill 2020, kur 86.3% e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt për sa i përket dhunës dhe krimit potencial.

Figura 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë




Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se ndjenja e sigurisë është më e ulët tek femrat (71.5%) sesa tek meshkujt (75.4%). Perceptimi i sigurisë tek femrat ka rënë për 5.2 pikë përqindjeje krahasuar me majin 2021 (76.7%), ndërsa ai i meshkujve mbeti pothuajse i njëjtë (76%). Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë një rritje substanciale në perceptimin e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës, me shumicën prej tyre që ndihen të sigurt në rrugë. Perceptimi për sigurinë në mesin e serbëve të Kosovës është rritur me 16.1 pikë përqindjeje, me 50.8% që ndihen të sigurt në vjeshtë 2021 krahasuar me 38.4% në maj 2021. Vlen të theksohet se perceptimi i sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës është më i lartë se në prill 2020 (46.2%) dhe dhjetor 2020 (46.2%), kur janë raportuar të dhënat për sigurinë. Në mënyrë të ngjashme me anketën e mëparshme, perceptimi më i lartë për sigurinë është regjistruar në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, me 85% (85% në maj 2021) që ndihen të sigurt kur janë jashtë. Gjithsej 73.6% e shqiptarëve të Kosovës ndihen të sigurt në rrugë.

Indekset e Demokrazizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Anketa e Pulsit Publik e vjeshtës 2021 ka regjistruar një rritje të Indeksit të Demokrazizimit (ID) dhe Indeksit të Besueshmërisë Ekonomike (IBE), dhe të dy kanë arritur vlerat më të larta të regjistruara ndonjëherë nga Pulsi Publik.⁴ Më konkretisht, ID-ja aktuale ka kapur vlerën prej 1.59, e cila është 0.01 pikë më e lartë sesa në maj 2021 (1.58) dhe 0.27 pikë më e lartë sesa në dhjetor 2020 (1.32). Kjo shifër sugjeron se më shumë se gjysma e qytetarëve në Kosovë kanë pikëpamje pozitive për proceset demokrazike në Kosovë.

Një rritje e ngjashme mund të vërehet në IBE, që është rritur nga vlera prej 1.49 në maj 2021 duke kapur vlerën 1.52 në vjeshtë 2021. Kjo është hera e parë që IBE shënon një trend pozitiv, duke sugjeruar se më shumë se gjysma e qytetarëve të Kosovës kanë pikëpamje pozitive për perspektivën ekonomike të Kosovës.

Figura 4 Indekset e Demokrazizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike



Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja janë të përbërë nga një numër komponentësh që përdoren për të gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponentë të paraqitur në Tabelën 2 më poshtë. Pyetjet për këtë indeks mund të përgjigjen me “Po, plotësisht”, “Po, kryesisht”, “Jo aq shumë”, ose “Aspak”. Tabela 2 tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjen me “Po, plotësisht” ose “Po, kryesisht” në nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e ID-së, të dhënat nga anketa e vjeshtës 2021 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme. Gjetjet tregojnë se jo çdo komponent i ID-së i listuar në Tabelën 2 ka dëshmuar rritje krahasuar me majin 2021. Gjithsej 70.9% e të anketuarve besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokrazike dhe sipas standardeve ndërkombëtare, krahasuar me 70.4 në maj 2021, 45.9% në dhjetor 2020, 66.3% në prill 2020, 62.7% në nëntor 2019 dhe 35.6% në maj 2019, duke bërë që ky të jetë komponenti i ID-së me vlerësimin më të lartë.

⁴ ID-ja dhe IBE-ja janë masa të vazhdueshme nga 0 në 3, në të cilat një rezultat nga 0 në 1.5 nënkupton se shumica e popullatës e sheh negativisht demokrazinë apo trendet ekonomike, dhe rezultati nga 1.5 në 3 nënkupton se shumica e popullatës e sheh pozitivisht demokrazizimin ose trendet ekonomike.

Gjithsej 63% konsiderojnë se Kuvendi e monitoron performancën e ekzekutiv, krahasuar me 60.1% në maj 2021, 45.6% në dhjetor 2020, 58% në prill 2020 dhe 38.6% në nëntor 2019. Edhe pse me vlerësimin më të ulët krahasuar me komponentët e tjerë të ID-së (44.9%), komponenti i gjyqësorit ka rritjen më të lartë krahasuar me majin 2021 (37.5%), me rritje prej 7.4 pikë përqindjeje. Gjithsej 60.7% e të anketuarve konsiderojnë se mediat gëzojnë lirinë e shprehjes - kjo vlerë shënon një rënie prej 8.5 pikë përqindjeje krahasuar me majin 2021 (69.2%) por mbetet më e lartë se dhjetori 2020 (57.9%). Rënie është vërejtur edhe në perceptimet mbi rolin e organizatave të shoqërisë civile si monitorues të sinqertë të ekzekutivit, me 55.6% që besojnë se kjo është e vërtetë krahasuar me 56.6% në maj 2021, 45.8% në dhjetor 2020 dhe 50.7% në prill 2020.

Të anketuarit duket se janë më të kënaqur me performancën e qeverisjes lokale sesa me ekzekutivin qendror. Teksa e para shënoi rritje nga 52.6% në maj 2021 në 54.9% në vjeshtë 2021, e dyta shënoi rënie nga 54.4% në maj 2021, në 49.3% në vjeshtë 2021. Një rënie e lehtë vërehet në përgjigjet në pyetjen nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse përputhen me standardet e të drejtave të njeriut, me 59.5% përgjigje pozitive krahasuar me 58.1% në maj 2021. Për fund, krahasuar me majin 2021(58.6%) vërehet një rënie prej 3 pikë përqindjeje edhe në përgjigjet në pyetjet nëse proceset demokratike në Kosovë janë krijuar dhe po shkojnë në drejtimin e duhur (55.6%). Ngjashëm me anketën e mëparshme të, të dhënat e vjeshtës 2021 të zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se teksa shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe të anketuarve nga komunitetet e tjera të Kosovës u përgjigjën me “po plotësisht”, dhe “po kryesisht” në të gjitha pyetjet përveç njërës,⁵ shumica e serbëve të Kosovës u përgjigjën me “aspak” dhe “jo aq shumë” në të gjitha pyetjet e komponentëve të ID-së.

Tabela 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së

Po Kryesisht dhe Po plotësisht	Mar - 15	Sht - 15	Pri - 16	Tet - 16	Tet - 17	Maj-18	Nën-18	Maj-19	Nën - 19	Pri-20	Dhj-20	Nën - 21	Nën - 21	Trend
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	26.20%	23.00%	30.30%	28.00%	44.60%	50.90%	53.70%	35.60%	62.73%	66.30%	45.87%	70.44%	70.88%	
A e monitorin Kuvendi performancën e ekzekutivit qendror?	21.20%	21.80%	26.60%	30.80%	36.10%	46.70%	48.30%	38.10%	38.61%	58.00%	45.56%	60.13%	62.95%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	13.60%	17.60%	21.00%	21.60%	31.20%	43.60%	46.00%	21.50%	31.48%	39.70%	36.66%	37.50%	44.88%	
A gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes?	35.50%	46.50%	47.30%	42.30%	52.50%	52.80%	59.10%	45.60%	46.66%	69.10%	57.94%	69.24%	60.70%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	19.50%	23.10%	32.10%	30.10%	34.30%	48.30%	57.50%	32.60%	34.79%	50.70%	45.77%	56.56%	55.62%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	23.30%	27.20%	28.90%	30.40%	34.00%	50.20%	49.20%	29.80%	29.62%	56.70%	41.53%	52.64%	54.88%	
A funksionon ekzekutivi qendror sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	11.80%	15.50%	18.90%	17.90%	24.70%	39.90%	37.50%	18.10%	24.23%	54.90%	30.61%	54.39%	49.28%	
A janë kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	23.50%	19.80%	31.70%	31.80%	41.40%	53.40%	60.50%	33.40%	40.30%	64.00%	42.82%	58.07%	59.49%	
Pavarësisht nga politika përditshme dhe me vështrimin drejt të ardhmes, a pranoi se proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	17.30%	15.40%	23.10%	23.80%	29.70%	46.90%	57.20%	22.40%	33.01%	42.50%	36.22%	58.65%	55.65%	

⁵ Në pyetjen për gjyqësorin, shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës u përgjigjën me “aspak” dhe “jo aq shumë”.

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e IBE-së, përgjigjet aktuale pozitive për komponentët e IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme, siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë “të favorshme”, “jo të favorshme” dhe “neutrale”. Gjithsej 15.9% e të anketuarve kanë pritshmëri të favorshme në lidhje me të hyrat totale të familjes brenda gjashtë muajve të ardhshëm, çka përbën vlerë të ngjashme me majin 2021 dhe rritje prej 4.4 pikë përqindjeje nga dhjetori 2020 (11.5%). Vërehet rritje e këndvështrimit pozitiv edhe në mënyrën si i shohin të anketuarit kushtet për të bërë biznes në Kosovë, me 12.8% që i konsiderojnë të favorshme – rritje nga 4.7% në maj 2021 dhe 7.2% në dhjetor 2020. Rritje e ngjashme krahasuar me majin 2021 (7%), dhjetorin 2020 (5.6%) dhe prillin 2020 (6.6%) vërehet në mënyrën si i shohin të anketuarit kushtet aktuale të punësimit, me 10.8% që i shohin si të favorshme. Për fund, vërehet një rënie në mënyrën si i shohin të anketuarit kushtet e ardhshme të punësimit - gjashtë muaj nga anketa e vjeshtës 2021 - gjithsej 15.9% i shohin si të favorshme, krahasuar me 18.8% në maj 2021. Kjo shifër është ende më e lartë se në dhjetor 2020 (8.3%) dhe prill 2020 (7.3%). Si përmbledhje, komponentët e IBE-së sugjerojnë që më shumë se gjysma e qytetarëve të Kosovës (1.52) kanë pikëpamje optimiste për ekonominë.


Tabela 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së

Të favorshme	Mar - 15	Sht - 15	Pri - 16	Tet - 16	Tet - 17	Maj-18	Nën-18	Maj-19	Nën - 19	Pri-20	Dhj-20	Nën - 21	Nën - 21	Trend
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot	15.10%	15.90%	23.40%	18.00%	22.40%	19.90%	18.80%	11.60%	13.70%	14.20%	11.50%	15.90%	15.90%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit	8.10%	8.30%	14.40%	13.10%	17.90%	18.50%	16.70%	5.50%	9.10%	8.20%	7.20%	4.70%	12.80%	
Cili është vlerësimi juaj për gjendjen aktuale të punësimit?	5.00%	6.80%	10.30%	7.70%	17.10%	15.40%	15.90%	5.80%	7.40%	6.60%	5.60%	7.00%	10.80%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot	6.00%	8.00%	14.00%	10.70%	18.70%	17.80%	23.30%	4.60%	12.00%	11.60%	8.30%	18.80%	15.90%	

Drejtimi Ekonomik

Rritja në perceptimet pozitive, krahasuar me majin 2021, mund të vërehet edhe në kënaqshmërinë e të anketuarve me drejtimin ekonomik të Kosovës. Gjatë vjeshtës 2021, 22.3% e të anketuarve ishin të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës për dallim nga 18.4% në maj 2021, 6.9% në dhjetor 2020 dhe 10.7% në prill 2020. Rrjedhimisht, numri i të pakënaqurve ka rënë nga 53.5% në maj 2021, në 44,6% në vjeshtë 2021. Gjithsej 33.1% nuk janë as të kënaqur e as të pakënaqur. Për dallim nga maji 2021, kur meshkujt ishin më të kënaqur me drejtimin ekonomik sesa femrat, në vjeshtën e vitit 2021 femrat duken më të kënaqura sesa meshkujt. Teksa 23.1% e femrave janë të kënaqura me drejtimin ekonomik të Kosovës, 20.8% e meshkujve ndihen njësoj. Për rrjedhojë, 45.7% e meshkujve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, kundrejt 49.2% të femrave që ndihen njësoj. Të dhënat e zberthyera sipas përkatësisë etnike sugjerojnë se niveli i pakënaqësisë në mesin e shqiptarëve të Kosovës është 43.5%, kurse me serbëve të Kosovës është 59.6%. Niveli i pakënaqësisë mes pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës është 56%. Prandaj, grupi më i kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës janë shqiptarët e Kosovës (23.2%), ndjekur nga të anketuarit nga komunitetet e tjera të Kosovës (17%), dhe serbët e Kosovës (5.4%).

Figura 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës




Problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht

Anketa e Pulsit Publik e vjeshtës 2021 hulumtoi edhe problemet më kryesore me të cilat përballet Kosova aktualisht. Gjetjet tregojnë një ndryshim nga anketa e mëparshme në tri çështjet madhore që ndikojnë në mirëqenien sociale, me problemet mjedisore që ia kanë zënë vendin korrupsionit si çështja e tretë më madhore. Tri çështjet kryesore të raportuara gjatë kësaj ankete ishin papunësia (26.7%), varfëria (24.3%) dhe problemet e hapësirës urbane (6.7%), ndërkohë që papunësia, varfëria dhe korrupsioni ishin tri shqetësimet kryesore në maj 2021. Krahasuar me majin e vitit 2021, korrupsioni (9.3%) ka rënë me 4.5 pikë përqindjeje. Problemet e hapësirës urbane dhe çmimet e artikujve esenciale janë ndër 5 çështjet kryesore me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës.

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se serbët e Kosovës i konsiderojnë problemet e hapësirës urbane (20%), papunësinë (13.8%) dhe sigurinë publike dhe personale (11%) si tri problemet më madhore, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh është papunësia (58.5%), pasuar nga problemet e hapësirës urbane (14%) dhe mjedisi (5.5%). Për shqiptarët e Kosovës, varfëria (26.5%), papunësia (25.1%) dhe mjedisi (10.4%) janë tri problemet më madhore në Kosovë.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt dhe femrat janë kryesisht të shqetësuar për papunësinë, varfërinë dhe mjedisin. Si femrat (24.1%) ashtu edhe meshkujt (24.4%) duket se janë njëloj të shqetësuar për varfërinë. Sidoqoftë, femrat janë më të shqetësuar për papunësinë dhe mjedisin (përkatësisht 28.4% dhe 10.5%) sesa meshkujt (përkatësisht 25% dhe 9.8%).

Figura 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht




Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat

Anketa e vjeshtës 2021 tregon se 27% e të anketuarve konsiderojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, kurse 73% mendojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Gjetjet tregojnë dallim të vogël nga anketa e majit 2020 kur 24% e të anketuarve mendonin se punësimi bëhet në baza meritore dhe 76% mendonin se nuk bëhet në baza meritore. Të anketuarit konsiderojnë faktorët vijues kryesorë për punësim në sektorin publik: lidhja partiake (25.5%), lidhjet familjare (25.2%), ryshfeti (14.8%), arsimi (14.6%), aftësimi profesional (7.5%) dhe, në masë më të vogël, miqtë (6.2%), dhe përvoja profesionale (5.1%). Gjithsej 27% e të anketuarve besojnë se arsimi, aftësimi profesional dhe përvoja profesionale janë faktorë të rëndësishëm për sigurimin e punësimit në sektorin publik. Në maj 2021, kjo shifër ishte 21.9%.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë dallime të pakta në perceptimet e meshkujve dhe femrave në lidhje me punësimin në baza meritore. Gjithsej 25.8% e meshkujve besojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, krahasuar me 28.3% të femrave që mendojnë të njëjtën gjë. Për meshkujt (28,2%), lidhjet familjare janë mënyra më e dobishme për t'u punësuar në sektorin publik, ndërsa për femrat (25.7%) lidhja partiake mundëson punësim më të lehtë në sektorin publik.

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se lidhjet partiake duket se janë faktori kyç për sigurimin e punësimit për shqiptarët e Kosovës (25.8%), serbët e Kosovës (28.7%), kurse për komunitetet e tjera të Kosovës është arsimi që e mundëson punësimin në sektorin publik (31.7%). Ngjashëm me anketat e dhjetorit 2020 dhe majit 2021, besimi më i vogël në punësimin në baza meritore gjendet mes serbëve të Kosovës (23.4%), pasuar nga shqiptarët e Kosovës (26.7%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (45.2%). Këta të fundit kanë besimin më të lartë në punësimin në baza meritore, me arsimin, përvojën profesionale dhe aftësimin profesional si faktorë vendimtarë për punësimin në sektorin publik.

Figura 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik



Krahasuar me anketën e majit 2021, besimi për punësimin në baza meritore në sektorin privat ka rënë nga 54.4% në 48.8%. Shumica e të anketuarve (51.2%) besojnë se punësimi në sektorin privat nuk bëhet në baza meritore. Të anketuarit identifikuan faktorët e mëposhtëm jo meritore për të siguruar punësim në sektorin privat: lidhjet familjare (28.3%), miqtë (13.8%), ryshfeti (7.3%), lidhja partiake (3.6%), paraqitja e jashtme (2.2%) dhe, në masë më të vogël, gjinia (0.6%).

Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (48.5%) dhe femrat (47.8%) kanë besim të ngjashëm në punësimin në baza meritore në sektorin privat. Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime domethënëse në perceptimet rreth meritokracisë në sektorin privat. Më shumë besim në meritokraci si kriter për punësim në sektorin privat kanë pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës me 60% që kanë besim, pasuar nga serbët e Kosovës me 49.6% dhe shqiptarët e Kosovës, të cilët kanë më së paku besim në meritokracinë si kriter. Besimi i tyre në punësimin në baza meritore në sektorin privat ka rënë nga 55.6% në maj 2021 në 48.4% në vjeshtën e vitit 2021.

Figura 8 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat



Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë

Mesatarisht, 23.4% e anketuarve pohojnë se perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Kjo vlerë përfaqëson një rënie prej 1.6 pikë përqindjeje nga maji 2021 (25%), 4.6 pikë përqindjeje nga dhjetori 2020 (28%), por një rritje prej 2.7 pikë përqindjeje krahasuar me prillin 2020 (20.7%), kur Puls i Publik regjistroi vlerën më të ulët për korrupsionin në shkallë të gjerë. Sidoqoftë, ky rezultat tregon një trend të qëndrueshëm pozitiv në perceptimin për korrupsionin në shkallë të gjerë krahasuar me vitet e mëparshme, siç tregohet në Tabelën 4.

Sektori i arsimit perceptohet si më pak i korruptuar, me 16.8% që besojnë se ka korrupsion në shkallë të gjerë në shkolla dhe universitete, i pasuar nga organizatat ndërkombëtare (17.6%), sistemi i kujdesit shëndetësor (18.8%), qeverisja lokale (19.1%) dhe institucionet / administrata qendrore e Kosovës (19.5%).

Ndryshe nga dy anketat e mëparshme kur Policia e Kosovës perceptohej si organizata më pak e korruptuar (14% në maj 2021 dhe 15.3% në dhjetor 2020), në vjeshtën e vitit 2021, 20.5% e të anketuarve besojnë se në Policinë e Kosovës ka korrupsion në shkallë të gjerë. Organizatat më të korruptuara perceptohen të jenë Dogana (32.3%), pasuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) (29.4%) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) (28.85%). AKP-ja është perceptuar si organizata më e korruptuar në maj 2021 (39.3). Ndryshimet më të mëdha në perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: AKP-ja (29.4% krahasuar me 39.3% në maj 2021), Posta dhe Telekom i Kosovës (23.7% krahasuar me 31.6% në maj 2021), Policia e Kosovës (20.5% krahasuar me 14% në maj 2021), Gjykatat (27.7% krahasuar me 32.5% në maj 2021), kujdesi shëndetësor (18.8% krahasuar me 22.9% në maj 2021) dhe institucionet/administrata qendrore (19.5% krahasuar me 23.1% në maj 2021). Siç tregohet në tabelën më poshtë, shumica e sektorëve dhe organizatave perceptohen të jenë më pak të korruptuara sesa në maj 2021, përveç Policisë së Kosovës, ATK-së, organizatave ndërkombëtare dhe sektorit të arsimit, ku është rritur perceptimi për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë nuk tregojnë dallime ndërmjet meshkujve dhe femrave në lidhje me perceptimet e tyre për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë.


Tabela 4 Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë

	Mar - 15	Sht - 15	Pri - 16	Nën - 16	Tet - 17	Maj - 18	Nën - 18	Maj - 19	Nën - 19	Pri - 20	Dhj - 20	Maj - 21	Nën - 21	Trend
Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	52.60%	51.50%	37.90%	49.70%	25.50%	32.50%	25.70%	25.10%	33.40%	11%	25%	22.90%	18.80%	
KEDS	44.70%	35.60%	31.10%	31.40%	20.50%	33.00%	31.30%	40.70%	38.90%	27.30%	27.30%	26.10%	25.80%	
KEK											27.50%	25.30%	25.80%	
Gjykatat	42.90%	46.90%	42.30%	49.30%	24.90%	38.60%	29.10%	30.70%	42.00%	24.50%	31.60%	32.50%	27.70%	
Doganat	38.70%	41.30%	32.30%	45.20%	22.70%	39.10%	31.40%	29.30%	41.40%	30.60%	39.20%	34.30%	32.30%	
Administrata qendrore/qeveria	38.50%	36.00%	36.60%	49.20%	30.70%	34.70%	28.40%	36.70%	35.30%	20.80%	29.50%	23.10%	19.50%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	37.10%	38.30%	39.20%	45.70%	24.90%	34.50%	29.80%	40.70%	48.10%	36.60%	39.00%	39.30%	29.40%	
Komunat (qeverisja lokale)	33.80%	28.60%	30.00%	40.20%	25.50%	29.00%	26.40%	25.80%	29.80%	13.30%	24.70%	20.40%	19.10%	
Arsimi (shkollat, Universiteti)	29.30%	29.00%	17.50%	31.00%	16.30%	26.20%	19.90%	20.70%	26.10%	18.90%	24.70%	15.10%	16.80%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)	28.10%	25.00%	18.20%	32.50%	17.40%	28.90%	25.40%	35.30%	42.20%	13.60%	30.20%	27.40%	28.80%	
PTK	25.90%	25.20%	18.40%	29.60%	17.00%	27.80%	25.60%	44.20%	40.80%	37.90%	33.20%	31.60%	23.70%	
Bankat	24.30%	23.30%	23.10%	24.40%	13.10%	27.30%	26.10%	33.80%	34.10%	18.90%	28.10%	22.90%	22.20%	
Organizatat ndërkombëtare	20.40%	22.90%	16.00%	28.00%	10.80%	24.50%	10.70%	19.50%	23.60%	5.50%	23.80%	15.70%	17.60%	
Policinë e Kosovës (PK)	20.40%	19.00%	13.60%	21.10%	14.90%	25.70%	21.60%	17.00%	20.70%	9.80%	15.30%	14.00%	20.50%	

Për të kuptuar se çka i formon perceptimet për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, të anketuarit u pyetën për arsyet për opinionin e tyre për shtrirjen e korrupsionit. Ngjashëm me anketat e tjera në të shkuarën, gjetjet tregojnë se shumica e të anketuarve (59.2%) i kanë formuar opinionet e tyre përmes mediave të shkruara dhe elektronike, siç ilustron në Figurën 9 më poshtë.

Gjithsej 29.6% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë formojnë bazën e opinionëve të tyre në lidhje me shtrirjen e korrupsionit, ndërsa 11% e të anketuarve pohuan se në opinionet e tyre kanë ndikuar përvojat personale kur atyre iu janë kërkuar para, dhurata ose favore të tjera në këmbim të shërbimeve të caktuara. Vlera për këtë të fundit është rritur me 3.9 pikë përqindje krahasuar me anketën e muajit maj 2021 (7.1%).


Figura 9 Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë



Qëndrimet kundrejt votimit


Anketa e Pulsit Publik e vjeshtës 2021 hulumtoi edhe qëndrimet e qytetarëve të Kosovës ndaj votimit. Qëndrimet ndaj votimit kanë ndryshuar krahasuar me anketën e muajit maj 2021, duke treguar një ulje të besimit në efektin e votës popullore për të shkaktuar ndryshime politike. Në pyetjen nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 29.4% e të anketuarve deklaruan se vota e tyre mund të sjellë ndryshime, krahasuar me 43.8% në maj 2021, 34.1% në dhjetor 2020 dhe 46.7% në prill 2019. Nga ana tjetër, 37.1% konsiderojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, krahasuar me 25.1% në maj 2021, 27.4% në dhjetor 2020 dhe 26.8% në prill 2020, duke treguar një trend negativ krahasuar me tri anketat e mëparshme. Në vjeshtën e vitit 2021, 31.2% konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në një farë mase, krahasuar me 23.9% në maj 2021, ndërsa vetëm 2.1% nuk e dinë nëse vota e tyre mund të sjellë ndryshime ose refuzuan të përgjigjen.

Figura 10 Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë



Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat janë më skeptike sesa meshkujt kur është fjala për ndikimin e votës së tyre. Ndërkohë që 32.2% (47.2% në maj 2021) e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, vetëm 26.5% (40.6% në maj 2021) e femrave mendojnë të njëjtën gjë. Gjithsej 36.2% e meshkujve dhe 37.8% e femrave besojnë se vota e tyre nuk mund të sjellë ndryshime, ndërsa 29.8% e meshkujve dhe 32.7% e femrave mendojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri diku.


Figura 11 Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë



Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme në besimin në zgjedhje si një mekanizëm për të sjellë ndryshime në Kosovë. Në përgjithësi, vërehet një rritje e besimit tek vota e tyre si mekanizëm për ndryshim tek serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës, ndërsa rënia është e dukshme tek shqiptarët e Kosovës. Gjithsej 5.7% e serbëve të Kosovës (2.4% në maj 2021 dhe 8.1% në dhjetor 2020) konsiderojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë, përkundrajt 30% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (16.9% në maj 2021 dhe 26.5% në dhjetor 2020) dhe 30.8% e shqiptarëve të Kosovës (48.2% në maj 2021 dhe 35.5% në dhjetor 2020).


Ndërkohë që gjithsej 37% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime (47.3% në maj 2021 dhe 37% në dhjetor 2020), të njëjtën gjë e mendonin edhe 19% e serbëve të Kosovës (34.8% në maj 2021 dhe 42.4% në dhjetor 2020) dhe 37.7% e shqiptarëve të Kosovës (22.9% në maj 2021 dhe 25.8% në dhjetor 2020). Ashtu si në anketën e majit 2021, më i larti është numri i serbëve të Kosovës që besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri diku (57.6%), pasuar nga shqiptarët e Kosovës (30%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (27.5%).

Figura 12 Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë



Anketa e Pulsit Publik e vjeshtës 2021 hulumtoi edhe për gjasat që të anketuarit të votojnë nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, si dhe preferencat e tyre për votim. Gjetjet tregojnë se 77.6% e të anketuarve (krahasuar me 75.3% në maj 2021, 80.9% në dhjetor 2020 dhe 70.2% në prill 2020) do të votonin për një parti të caktuar politike, ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në të ardhmen e afërt. Ndërkohë që 6.8% e të anketuarve nuk kishin ndonjë preferencë politike (krahasuar me 7.4% në maj 2021, 9.2% në dhjetor 2020 dhe 13.9% në prill 2020), 11% e të anketuarve thanë se nuk do të votonin (krahasuar me 10% në maj 2021, 7% në dhjetor 2020, 7.4% në prill 2020), kurse 5.4% refuzuan të përgjigjen.


Figura 13 Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore mbahen së shpejti



Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë trend rënës të gjasave për të votuar për të dy gjinitë, si dhe dallime minimale mes meshkujve dhe femrave në lidhje me gjasat e tyre për të votuar nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti (78.3% e meshkujve dhe 75.2% e femrave krahasuar me 83.7% të meshkujve dhe 82% të femrave në maj 2021, dhe 93.4% të meshkujve dhe 92.2% të femrave në dhjetor 2020). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike sugjerojnë rritje të gjasave për të votuar në mesin e serbëve të Kosovës (57.6%), krahasuar me majin 2021 (42.9%). Gjithsej 59.1% e serbëve të Kosovës kishte gjasa të votonin në dhjetor 2020 dhe 68.1% në prill 2020. Shqiptarët e Kosovës nuk shfaqin asnjë ndryshim në krahasim me majin 2021 në gjasat e tyre për të votuar (77.5% në vjeshtë 2021 kundrejt 77.3% në maj 2021). Megjithatë, këto shifra sugjerojnë një rënie krahasuar me 84.4% në dhjetor 2020. Më shumë pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës do të votonin në vjeshtë të vitit 2021 (78%) sesa në maj 2021 (70.2%), por më pak se në dhjetor 2020 (89.4%).

Vetëm 6.9% e shqiptarëve të Kosovës (5.8% në maj 2021 dhe 9.2% në dhjetor 2020), 5.7% e serbëve të Kosovës (14.8% në maj 2021 dhe 16.7% në dhjetor 2020), dhe 6% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (9.5% në maj 2021 dhe 5% në dhjetor 2020) nuk kishin preferenca politike, ndërsa 10.9% e shqiptarëve të Kosovës (9.6% në maj 2021), 17.1% e serbëve të Kosovës (22.9% në maj 2021), dhe 9% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (9.5% në maj 2021) deklaruan se nuk do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti. Gjithsej 19.5% e serbëve të Kosovës, ndjekur nga 7% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 4.7% e shqiptarëve të Kosovës, refuzuan të përgjigjen në këtë pyetje.


Figura 14 Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike



Mjedisi


Të anketuarit u pyetën për njohuritë e tyre në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Anketa e Pulsit Publik e vjeshtës 2021 nxjerr në pah dallime të konsiderueshme krahasuar me anketën e majit 2021 kur flitet për qytetarët që pohojnë se kanë më pak njohuri në lidhje me të drejtën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Gjithsej 7.9% (16.1% në maj 2021 dhe 8.2% në dhjetor 2020) thanë se dinë shumë për këtë temë, 24.9% (32.7% në maj 2021 dhe 27.4% në dhjetor 2020) pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 39.7% e të anketuarve (36% në maj 2021 dhe 37% në dhjetor 2020) thanë se pak dinë për këtë temë. Gjithsej 27.5% (15.2% në maj 2021 dhe 27.4% në dhjetor 2020) thanë nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Figura 15 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër




Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime thelbësore mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me vetëdijesimin e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 39.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 14.8% e serbëve të Kosovës dhe 26.7% e shqiptarëve të Kosovës deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje, çka (përveç mes serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera të Kosovës) tregon rritje të mungesës së njohurive krahasuar me majin 2021 (33.8% e serbëve të Kosovës, 35.8% e komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 12.4% e shqiptarëve të Kosovës). Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve (39.5%) që deklaruan se nuk kanë njohuri mbi këtë temë. Serbët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve me njohuri të pakta dhe mesatare në lidhje me temën (përkatësisht 33.3% dhe 44.8%). Shqiptarët e Kosovës udhëheqin sa u përket njohurive të shumta për këtë çështje (8.4%), pasuar nga serbët e Kosovës (7.1%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (1%).

Figura 16 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zërthyera sipas përkatësisë etnike




Një pyetje tjetër për mjedisin ishte e lidhur me vetëdijesimin e të anketuarve rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Teksa 5.1% (11.9% në maj 2021 dhe 6.8% në dhjetor 2020) e të anketuarve deklaruan se ishin plotësisht të vetëdijshëm për këto kërcënime, 67.9% (70.7% në maj 2021 dhe 65.8% në dhjetor 2020) e të anketuarve deklaruan se kishin pak njohuri ose njohuri mesatare rreth këtyre kërcënimeve. Gjithsej 27% (17.4% në maj 2021 dhe 27.4% në dhjetor 2020) e të anketuarve deklaruan se nuk kishin njohuri rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (5.3%) dhe femrat (4.9%) kanë njohuri të ngjashme për këtë temë. Femrat (26.2%) pohojnë se kanë më shumë njohuri mesatare sesa meshkujt (23.3%), por pak më pak femra (42.5%) sesa meshkuj (43.8%) pohojnë se kanë pak njohuri për këtë temë. Më shumë meshkuj (27.5%) pohojnë se nuk kanë njohuri për këtë temë sesa femrat (26.3%).

Figura 17 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre




Siç shihet në Figurën 18, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike nxjerrin në pah dallimet mes njohurive të grupeve etnike në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Gjithsej 35% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 26.3% e shqiptarëve të Kosovës dhe 10.5% e serbëve të Kosovës nuk kanë njohuri për këtë temë. Dallimi më i madh krahasuar me anketën e muajit maj 2021, është rënia e numrit të serbëve të Kosovës (35.7%) që nuk kanë njohuri për këtë temë dhe rritja e numrit të shqiptarëve të Kosovës (11.2%) që nuk kanë njohuri për këtë temë. Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri për temën (35%). Shqiptarët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të atyre që kanë pak njohuri (43.6%), ndërsa serbët e Kosovës janë të parët për zotërimin e njohurive mesatare (41.4%) për temën. Serbët e Kosovës udhëheqin edhe në pasjen e shumë njohurive në lidhje me këtë çështje (6.7% kundrejt 3.8% në maj 2021), pasuar nga shqiptarët e Kosovës (5.5% kundrejt 20.2% në maj 2021) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (0.5% kundrejt 9% në maj 2021).

Figura 18 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zërthyer sipas përkatësisë etnike




Anketa e Pulsit Publik XXI hulumtoi edhe vetëdijesimin rreth ndryshimeve klimatike. Gjithsej 12.3% besojnë se Kosova është e ndikuar nga ndryshimet klimatike dhe 49.7% besojnë se është e ndikuar deri diku nga ndryshimet klimatike. Gjithsej 30.7% besojnë se ndryshimet klimatike kanë pasur pak ndikim, ndërsa 7.3% besojnë se ato kanë pasur shumë pak ndikim në Kosovë. Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë dallime madhore ndërmjet opinionit të meshkujve dhe femrave për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë: gjithsej 61.6% e meshkujve dhe 62.6% e femrave besojnë se Kosova është shumë ose deri diku e ndikuar nga ndryshimet klimatike, ndërsa 38.3% e meshkujve dhe 37.4% e femrave besojnë se Kosova është pak ose shumë pak e ndikuar nga ndryshimet klimatike.

Figura 19 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë



Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se 66% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës besojnë se Kosova është shumë ose deri diku e ndikuar nga ndryshimet klimatike, pasuar nga 62.7% e shqiptarëve të Kosovës dhe 51.9% e serbëve të Kosovës. Këta të fundit kryesojnë në besimin se Kosova është pak ose shumë pak e ndikuar nga ndryshimet klimatike (48%), pasuar nga shqiptarët e Kosovës (37.4%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (34%).


Figura 20 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike



COVID-19


Anketa e vjeshtës 2021 përmbante pyetje në lidhje me pandeminë COVID-19. Të anketuarit u pyetën së pari rreth ndikimit të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike, shëndetin fizik dhe shëndetin mendor. Gjithsej 51% (60.7% në maj 2021, 68.7% në dhjetor 2020 dhe 65.9% në prill 2020) e të anketuarve deklaruan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në mirëqenien e tyre ekonomike. Ngjashëm me majin 2021, 43.9% (46.9% në dhjetor 2020 dhe 40.7% në prill 2020) deklaruan se ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre fizik. Gjithsej 50.7% (48.6% në maj 2021, 52.8% në dhjetor 2020 dhe 59% në prill 2020) treguan se ka ndikuar në shëndetin e tyre mendor. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se mirëqenia ekonomike e femrave (52%) është prekur më shumë se ajo e meshkujve (49.3%). Edhe shëndeti fizik i femrave (44.5%) është prekur më shumë se ai i meshkujve (42.2%). Vlen të theksohet se teksta ndikimi në mirëqenien ekonomike është më i ulët sesa në anketat e mëparshme, ndikimi në shëndetin fizik dhe mendor është më i lartë sesa në maj 2021. Ndikimi i COVID-19 në shëndetin mendor të femrave (50.5%) dhe meshkujve (49.6%) është afërsisht i njëjtë.

Figura 21 Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor




Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se ndikimi negativ i COVID-19 në mirëqenien ekonomike është ulur dukshëm mes të anketuarve nga të gjitha komunitetet etnike: gjithsej 51.9% (61.3% në maj 2021) e shqiptarëve të Kosovës, 38.6% (48.1% në maj 2021) e serbëve të Kosovës dhe 47% (58.2% në maj 2021) e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës raportuan ndikim negativ të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike. Gjithsej 35.5% e shqiptarëve të Kosovës, 28.1% e serbëve të Kosovës dhe 41% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës u përgjigjën se nuk kishin pasur asnjë efekt në mirëqenien e tyre ekonomike për shkak të shpërthimit të COVID-19. Ndërkohë që 43.5% e shqiptarëve të Kosovës raportuan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në shëndetin e tyre fizik, të njëjtën gjë e raportuan edhe 45.2% e serbëve të Kosovës dhe 38% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Në të njëjtën kohë, 50.8% e shqiptarëve të Kosovës, 48.6% e serbëve të Kosovës dhe 40% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës raportuan ndikim negativ të COVID-19 në shëndetin e tyre mendor. Ashtu si në anketën e mëparshme, këto shifra sugjerojnë se situata e krijuar nga shpërthimi i COVID-19 në Kosovë ka pasur efekte të mëdha negative në mirëqenien ekonomike të të anketuarve, të ndjekura nga efektet në shëndetin mendor dhe shëndetin fizik.

Figura 22 Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike




Të anketuarit u pyetën edhe nëse janë të kënaqur me masat e marra nga institucionet qendrore të Kosovës për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Të dhënat sugjerojnë rënie të nivelit të kënaqshmërisë në krahasim me anketën e muajit maj 2021, e cila regjistroi nivele të moderuara të kënaqshmërisë. Më konkretisht, 32.3% e të anketuarve janë të kënaqur me masat e kabinetit ekzekutiv, kundrejt 43.6% në maj 2021 dhe 78.8% në prill 2020. Niveli i kënaqshmërisë ishte më i ulëti në dhjetor 2020, kur vetëm 15% e të anketuarve ishin të kënaqur. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se femrat (34.6%) janë më të kënaqura me masat e marra nga kabineti ekzekutiv në përgjigje ndaj shpërthimit të pandemisë sesa meshkujt (29.7%). Niveli i pakënaqësisë është gjithashtu më i lartë tek femrat (32.8%) sesa tek meshkujt (30.6%). Megjithatë, numri i meshkujve të pakënaqur është më i madh se numri i atyre që janë të kënaqur.

Figura 23 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19



Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë edhe rënie të kënaqshmërisë në mesin e shqiptarëve të Kosovës, por rritje të kënaqshmërisë në mesin e komuniteteve të tjera të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në krahasim me anketën e muajit maj 2021. Gjithsej 32.9% (44.6% në maj 2021) e shqiptarëve të Kosovës janë të kënaqur me masat e kabinetit ekzekutiv, pasuar nga 44.5% (40.8% në maj 2021) e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, ndërsa vetëm 8.6% (5.7% në maj 2021) e serbëve të Kosovës kanë shprehur kënaqshmërinë e tyre me masat e marra nga kabineti ekzekutiv i Kosovës për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19. Ka rritje të pakënaqësisë në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, ndërsa ka rënie të pakënaqësisë në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës në krahasim me anketën e opinionit të majit 2021. Gjithsej 31% (25.1% në maj 2021) e shqiptarëve të Kosovës janë të pakënaqur, pasuar nga 59% (39.1% në maj 2021) e serbëve të Kosovës dhe 20% (28.4% në maj 2021) e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.

Figura 24 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, të dhëna të zërthyer sipas përkatësisë etnike



Metodologjia

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje bazohen në anketën me 1,306 të anketuar në Kosovë mbi moshën 18 vjeçare, të realizuar nga 20 tetori deri më 4 nëntor 2021. Mostra përfshiu numër të njëjtë të meshkujve dhe femrave nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke mbuluar si zonat urbane ashtu edhe rurale. Në aspektin e përfaqësimit etnik, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (boshnjakë të Kosovës, ashkali të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës) Anketa u krye në bazë të mostrimit me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe u krye përmes intervistave sy më sy. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.⁶

Peshimi i totaleve të popullatës

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen përlogaritjet për totalet, ekipi i Pulsit Publik bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

- Shqiptarë të Kosovës: 88%;
- Serbë të Kosovës: 6%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 6%.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptarë të Kosovës	1,616,869	92.93
Serbë të Kosovës	25,532	1.47
Turq të Kosovës	18,738	1.08
Boshnjakë të Kosovës	27,533	1.58
Goranë të Kosovës	10,265	0.59
Romë të Kosovës	8,824	0.51
Ashkali të Kosovës	15,436	0.89
Egjiptas të Kosovës	11,524	0.66
Të tjerët, refuzuan të deklarojnë dhe nuk janë në dispozicion	5,104	0.29
Gjithsej	1,739,825	100.00

⁶ Në raport përdoren termat përqindje dhe pikë përqindjeje. Një pikë përqindjeje është ndryshimi numerik mes dy përqindjeve; ndërsa përqindja është raporti i shprehur si fraksion i 100. Përqindja i referohet shkallës së ndryshimit, ndërsa pika e përqindjes mat sasinë reale të ndryshimit.

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

- Shqiptarë të Kosovës: 93%;
- Serbë të Kosovës: 2%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 5%.

Megjithatë, marrë parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet të shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës të konsideruar për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

- Shqiptarë të Kosovës: 92%;
- Serbë të Kosovës: 4%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës): 4%.

Përlllogaritja e Indekseve

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelit e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet vijuese në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse institucionet lokale dhe ato ekzekutive qendrore punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 deri në 1.5 do të thotë që shumica e të anketuarve konsiderojnë se demokratizimi nuk është në rrugën e duhur, kurse rezultati prej 1.5 deri në 3 do të thotë që shumica e të anketuarve pajtohen se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica.

